



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.199/1 Prot.

Tiranë, më 29 /01 / 2021

V E N D I M

Nr. 15, Datë 29 /01/ 2021

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, mori në shqyrtim ankesën nr.57 regj, datë 18.06.2020, paraqitur nga ankuesi E.D, kundër Bashkisë Kamëz, me pretendimin për diskriminim për shkak të bindjeve politike. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Lidhur me diskriminimin e pretenduar, ankuesi shpjegon sa më poshtë:

Bashkia Kamëz ka shpallur në *website-n* e saj “*Njoftim për vend të lirë pune*”, për pozicionin e “*Përgjegjës i Medias dhe Informimit, Bashkia Kamëz*”. Pasi u njoha me shpalljen për këtë pozicion pune me anë të shërbimit postar më datë 01.06.2020, kam paraqitur aplikimin tim dhe dokumentacionin shoqërues të kërkuar për këtë pozicion për procedurën e ngritjes në detyrë dhe procedurës së pranimit nga jashtë shërbimit civil.

Më datë 11.06.2020, me anë të njoftimit elektronik, jam informuar se Bashkia Kamëz më ka skualifikuar nga procedura e ngritjes në detyrë për shkak se nuk plotësoj kriterin e përcaktuar në nenin 26/3/b, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”. Pasi u njoha me vendimin dhe arsyetimin e Bashkisë Kamëz për skualifikimin tim nga procedura e shpallur për pozicionin “*Përgjegjës i zyrës së medias dhe informimit*”, më datë 11.06.2020 kam paraqitur ankesë me shkrim si dhe në rrugë elektronike, ankesë për të cilën nuk kam marrë asnjë përgjigje.

Duke qenë se, nga ana e Bashkisë Kamëz nuk më është kthyer asnjë përgjigje për ankesën e paraqitur, si dhe skualifikimi im është i padrejtë, ju jam drejtuar Juve për të kërkuar kryerjen e një hetimi administrativ për verifikimin e kësaj çështje, për asyret e mëposhtme:

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Unë E.D kam filluar punë pranë Bashkisë Kamëz më datë 03.05.2013 si “specialist i medias dhe informimit”. Në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në nenin 67/4 të tij, përcaktohet se: “Nëpunësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 3, të këtij neni, janë nëpunës civilë në periudhë prove dhe për ta zbatohen dispozitat e nenit 24 të këtij ligji. Periudha e provës fillon nga fillimi i shtrirjes së efekteve të këtij ligji”. Po ashtu në VKM-në nr.116, datë 05.03.2014 “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil” sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, përcaktohet se: “Punonjës ekzistues”, sipas pikës 3, të nenit 67, të ligjit nr.152/2013, që kryejnë funksione të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore e komuna dhe: a) janë rekrutuar sipas procedurave të ngjashme me ato të përcaktuara nga ligji nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, por që nuk e gëzojnë statusin e nëpunësit civil: apo b) jënë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se një vit, janë nëpunës civilë për shkak të ligjit. “Punonjës ekzistues” që mbajnë një pozicion të konsideruar si pjesë të shërbimit civil, sipas ligjit nr. 152/2013, në institucionet e administratës shtetërore e në komunë dhe që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë më pak se një vit, janë nëpunës civilë në periudhë prove. Periudha e provës fillon nga data e fillimit të efekteve të ligjit”.

Në zbatim të dispozitave të mësipërme ligjore, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, unë kam qenë në periudhë prove, të cilën e kam ezauruar. Kjo vërtetohet me dokumentacionin që është në zyrat e Bashkisë Kamëz, ku në dosjen time personale është edhe vlerësimi i bërë nga Shkolla e Administratës Publike (ASPA), për trajnimin e detyrueshëm që kam ndjekur për përfitimin e statusit të nëpunësit civil.

Më datë 26 mars 2019, për asryet e mia familjare kam shkëputur marrëdhëniet e punës dhe financiare me Bashkinë Kamëz. Në nenin 64, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” përcaktohet se: “Nëpunësi mund të njoftojë përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes me shkrim te njësia e burimeve njerëzore të institucionit, ku ushtron detyrën, ose DAP-it, në rastin e nëpunësit të TND-së”. Gjithashtu, në pikën 4, të nenit 64, përcaktohet se : “Nëpunësit civilë, të cilët janë larguar nga shërbimi civil si pasojë e dorëheqjes, kanë të drejtë që të konkurojnë si nëpunës civilë për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26 të këtij ligji, deri në 2 vjet pas përfundimit të marrëdhënies së punësimit në shërbimin civil.”

Në zbatim të kësaj dispozite ligjore, e cila më jep të drejtën të aplikoj si nëpunës civil për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, kam paraqitur aplikimin tim pranë Bashkisë Kamëz, për pozicionin e shpallur të lirë nga ana e tyre.

Vendimi për skualifikimin tim nga procedura për ngritjen në detyrë nga ana e Bashkisë Kamëz është për arsye të diskriminimit për shkak të bindjeve politike, pasi marrëdhëniet e mia të mëparshme të punës në Bashkinë Kamëz kanë qenë në kohën kur Bashkia Kamëz drejtohej nga subjekt i zgjedhur nga radhët e Partisë Demokratike, ndërsa tani kjo bashki drejtohet nga subjekt të zgjedhur nga Partia Socialiste.

Duke e pritur këtë diskriminim nga ana e tyre, aplikimi im për atë pozicion është kryer për të dyja procedurat e rekrutimit, si procedurën e “ngritjes në detyrë” ashtu edhe procedurën e “pranimit nga jashtë” dhe për të dyja procedurat jam skualifikuar.

Ankuesi deklaron se, nga një kontroll që ka bërë në [ëeb-in zyrtar ëëë.kamza.gov.al](http://ëeb-in.zyrtar.ëëë.kamza.gov.al), ka konstatuar se më datë 29.06.2020 është publikuar njoftim për vazhdim procedure, sipas të cilës rezulton se është kualifikuar për procedurën e pranimit në shërbimin civil. Sipas këtij njoftimi data e provimit është përcaktuar më datë 01.07.2020. Ankuesi shprehet se kjo është në shkelje flagrante të ligjit “Për nëpunësin civil” dhe aktet nënligjore përkatëse. Sipas ankuesit skualifikimi i tij nga procedura e ngritjes në detyrë si “përgjegjës i medias” ka patur si qëllim emërimin në këtë pozicion të personit Xh.S, i cili është shpallur fitues për këtë pozicion, ndërkohë që ankuesi ishte i vetmi kandidat që plotësonte kriteret.

Përfundimisht ankuesi ka kërkuar nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit dhe cënim e interesave të tij për punësim, për shkak të bindjeve politike nga ana e Bashkisë Kamëz, marrjen e masave të nevojshme për mbrojtjen e të drejtave të tij dhe vënien përpara përgjegjësisë të institucionit të Bashkisë Kamëz për zbatimin e ligjit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në datën 18.11.2020, kanë fyre në fuqi ndryshimet ligjore të miratuara me ligjin nr. 124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2020 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”². Meqënëse çështja objekt i këtij shqyrtimi administrativ është paraqitur përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 124/2020, atëherë Komisioneri vlerëson se çështja duhet të shqyrtohet sipas parashikimeve të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të pandryshuar.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”³, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, rregullon ndër të tjera, zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me bindjet politike, pretenduar nga ankuesi, duke parashikuar në nenin 1 të tij se : “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, **bindjet politike**, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër. ”

² Ligji nr.124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2020 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, është botuar në Fletoren Zyrtare Nr.191, datë 03.11.2020.

³ Në vijim do t’i referohemi me shkurtësën LMD.

Neni 3, i Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi. Në Kreun II, të LMD parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. LMD në nenin 12/1/a/b⁴, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, *bazuar në bindjet politike*, që i bëhet punëmarrësit në gëzimin e të drejtës për punësim, duke përfshirë këtu shpalljen e vendeve të lira të punës, si dhe rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenti 7 të LMD-së, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD-së dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të LMD. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën me nr.893 prot., datë 02.07.2020, Komisioneri ka kërkuar informacion nga Bashkia Kamëz .
- Me shkresën nr.5084/1 prot., datë 23.07.2020⁵, Bashkia Kamëz ka kthyer përgjigje, duke parashtruar:

Bashkia Kamëz më datë 15.05.2020 ka shpallur vendin e lirë të punës “përgjegjës i medias dhe Informimit” në *website-n* zyrtar të Bashkisë Kamëz. Më datë 03.06.2020, aplikanti E.D, ka dorëzuar pranë Bashkisë Kamëz dokumentat për konkurim. Më datë 11.06.2020 Bashkia Kamëz për fazën “ngritje në detyrë” ka shpallur në *website-n* zyrtar vazhdimin e procedurës së konkurimit për pozicionin “përgjegjës i medias dhe informimit” ku rezultoi se nuk ka patur asnjë kandidat që plotësonte kriteret dhe konkurimi ka vazhduar me fazën e “pranimin në shërbimin civil”. Më datë 11.06.2020 në bazë të pikës 2.3 të “Njoftimit të shpalljes së vendeve vakante” mbi njoftimin e kandidatit për shkaqet e moskualifikimit në fazën e “ngritjes në detyrë”, Bashkia Kamëz ka njoftuar E.D për shkaqet e moskualifikimit nëpërmjet *email-it* zyrtar të Bashkisë Kamëz.

Më datë 15.06.2020, pranë Bashkisë Kamëz është administruar ankesa e E.D me nr.4398 prot., mbi skualifikimin e tij në fazën e “ngritjes në detyrë”. Më datë 19.06.2020 me nr. 4398/1 prot.,

⁴ Neni 12/1/c, të ligjit nr. 10221/2010: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve;”

⁵ Protokolluar pranë Komisionerit me nr.893/1 prot., datë 27.07.2020.

Bashkia Kamëz i ka kthyer përgjigje ankesës së E.D duke sqaruar të gjitha arsyet e mosplotësimit të kriterëve për fazën e “ngritjes në detyrë”, arsye të njoftuara gjithashtu edhe në *email*-in zyrtar.

Në këto kushte Bashkia Kamëz ka vazhduar procedurën për pranimin në shërbimin civil dhe në *website-n* e Bashkisë Kamëz më datë 29.06.2020, është shpallur vazhdimi i procedurës për pranimin në shërbimin civil, ku aplikimi i E.D është pranuar dhe është shpallur data e provimit më 01.07.2020, ora 10.30. Pranë Bashkisë Kamëz në datën e shpallur për provim rezulton se është paraqitur vetëm një konkurent. E.D nuk është paraqitur për dhënien e provimit në orën dhe datën e caktuar, sipas parashikimeve të nenit 20/2 ku përcaktohet se: *“Procesi përzgjedhës bazohet në vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatëve nëpërmjet një konkurimi kombëtar, që përfshin një testim të shkruar, një testim me gojë dhe çdo formë tjetër të përshtatshme të verifikimit të aftësive, si dhe vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatit.”*

Sqarojmë se përzgjedhja e fituesit të vendit vakant vendoset në bazë të vlerësimit të aftësive nëpërmjet testimit. Mosparaqitja e E.D në ditën dhe orën e përcaktuar në shpalljen zyrtare për zhvillimin e testimit me shkrim, përbën shkak të drejtëpërdrejtë për moskualifikimin e tij.

- Ankuesi ka dërguar kundërshtimet e tij në lidhje me qëndrimin e mësipërm të Bashkisë Kamëz në datë 17.08.2020⁶.

Duke i'u qëndruar shpjegimeve të dhëna edhe në ankesë, ankuesi ka shtuar se njoftimi i Bashkisë Kamëz për zhvillimin e konkursit në datën 01.07.2020 është realizuar në mungesë të transparencës, pasi njoftimi në faqen zyrtare të Bashkisë Kamëz, është hedhur vetëm me shënimin *“vazhdim procedure pranimi”* pa shënuar pozicionin e punës, ndryshe nga praktika që Bashkia Kamëz ndjek në shpallje të tjera. Gjithashtu njoftimi është bërë në datën 29.06.2020, ndërsa konkursi është caktuar në datën 01.07.2020, me qëllim që ankuesi të mos merrte njoftim dhe procedurat të vazhdonin në mungesën e tij. Kjo mungesë transparence dhe ky nxitim nga ana e Bashkisë Kamëz, sipas ankuesit, tregon qartë qëllimin keqdashës që ai të mos informohej për datën e zhvillimit të testimit dhe të ishte rruga e hapur për emërimin e personit të zgjedhur prej tyre.

Gjithashtu në këto kundërshtime ankuesi ka ngritur pretendime mbi korrektësinë e procedurave të ndjekura nga Bashkia Kamëz për pranimin e dokumentacionit, zhvillimin e konkursit dhe shpalljen e fituesit për këtë pozicion pune. Sipas ankuesit, Bashkia Kamëz prej kohësh kishte punësuar *“de facto”* në këtë pozicion pune edhe pse jo *“de jure”*, kandidatin tjetër Xh. S, i cili tashmë është emëruar në këtë pozicion. Sipas ankuesit, Bashkia Kamëz e ka skualifikuar ankuesin nga procedura e ngritjes në detyrë, pasi kandidati i cili është shpallur fitues nuk plotësonte kriteret e ngritjes në detyrë, por vetëm të pranimit në shërbimin civil. Sipas ankuesit, edhe në këtë procedurë janë kërkuar kriteret minimale, pasi vetëm ato kriteret mund të plotësonte ai kandidat.

- Në datën 25.08.2020, Komisioneri⁷, i është drejtuar ankuesit me një kërkesë për informacion, ku ndër të tjera është kërkuar sqarimi i çështjeve si vijon:

⁶ Kundërshtimet janë dërguar në rrugë elektronike, nëpërmjet adresës së *email-it*, sipas *email-it* date 17.08.2020

- A dispononte ankuesi kopje të aktit të konfirmimit si nëpunës civil dhe nëse po, a e kishte dorëzuar këtë dokument në aplikimin për vendin e punës;

- Dhënien e shpjegimeve dhe informacioneve në lidhje me bërjen publike të bindjeve të tij politike apo pasjes dijeni mbi bindjet politike të personit i cili ishte shpallur fitues (Xh.S), i cili sipas ankuesit ishte kandidat që ishte paracaktuar për të fituar nga ana e Bashkisë Kamëz.

- Ankuesi ka kthyer përgjigje, në lidhje me sa është kërkuar, në datën 26.08.2020⁸, duke parashtruar sa më poshtë vijon:

Për sa i përket aktit të konfirmimit si nëpunës civil, ankuesi nuk dispononte një kopje të këtij akti, pasi ai ndodhet në dosjen e personelit që disponon vetë Bashkia Kamëz. Më tej ankuesi thekson faktin se bazuar në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, përfundimin me sukses të kursit të trajnimit të detyrueshëm për nëpunësit civil të administratës vendore në periudhë prove dhe pajisjen me çertifikatën e datës 16.05.2016 të lëshuar nga Shkolla e Administratës Publike, si dhe faktin që nga data e emërimit deri në datën e largimit me dëshirë, ai ka punuar në të njëjtin pozicion pune, po në të njëjtin institucion, ai gëzonte statusin e nëpunësit civil.

Në lidhje me bindjet e tij politike, ankuesi sqaron se: *“...kam qenë dhe jam ndër aktivistët e Partisë Demokratike, bindje të cilat i kam shfaqur në çdo moment dhe me çdo mjet të mundshëm, qoftë me prani fizike në aktivitete politike të zhvilluara nga Partia Demokratike, qoftë edhe në rrjete sociale. Gjithashtu në zgjedhjet e vitit 2017 unë kam qenë edhe komisioner i qendrës së votimit, ku kam përfaqësuar subjektin politik PD. Po ashtu, në hapjen e fushatës elektorale të vitit 2017 unë kam qenë një nga pjesmarrësit të cilët u helmuan nga një gaz i lëshuar në rrethana akoma të paqarta dhe të pazbuluara. Për këtë helmim jam paraqitur në QSUT ku kam marrë edhe trajtim mjekësor. Po ashtu për këtë ngjarje kam dhënë edhe deklaratë për mediat e cila është e aksesueshme edhe në internet. Për sa më sipër, bindjet e mia politike janë të shfaqura në të gjitha mënyrat të cilat janë të aksesueshme dhe publike për këdo dhe ku Bashkia Kamëz ka të gjitha mundësitë për të patur dijeni mbi bindjet e mia politike.”*

Për sa i përket kandidatit i cili është shpallur fitues, ankuesi deklaroi se: *“...në dijeninë time bindjet e tij politike janë për Partinë Socialiste, pasi ai është anëtar i kësaj partie. Po të kontrollosh në rrjetin e tij social “facebook”, do të konstatohet se ai shpërndan çdo postim politik dhe administrativ të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, të Kryeministrit dhe të Partisë Socialiste. Këto postime janë shpërndarë përpara dhe pas emërimit të tij në këtë pozicion pune. Pra, është e qartë që ky person është favorizuar politikisht, për të qenë fitues i këtij vendi pune, ndërsa unë jam diskriminuar politikisht.”*

- Me shkresën nr. 767/1 prot., datë 02.09.2020, Komisioneri ka kërkuar informacion nga Bashkia Kamëz, në mënyrë të veçantë në lidhje me mënyrën e dorëzimit të aplikimit nga ana e aplikantit Xh.S, procedurat e shpalljes së fituesit, kopje të aktit të konfirmimit të statusit të

⁷ Kërkesa për informacion i është drejtuar ankuesit në rrugë elektronike, sipas email-it datë 25.08.2020.

⁸ Përgjigja e ankuesit është administruar në rrugë elektronike, sipas email-it datë 26.08.2020.

nëpunësit civil për ankuesin, vlerësimin e fundit të punës për ankuesin si dhe nëse ai ka patur ose jo masa disiplinore.

- Me shkresën nr.6705/1 prot., datë 08.09.2020⁹, Bashkia Kamëz ktheu përgjigje, por nuk dha informacion për të gjitha çështjet e parashtruara.
- Bazuar në nenin 33/8, të ligjit nr.10221/2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*¹⁰ dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, në datën 28.10.2020, Komisioneri zhvilloi një seancë dëgjimore publike. Seanca u zhvillua në mungesë të ankuesit, i cili njoftoi Komisionerin se për shkak se ndodhej jashtë shtetit e kishte të pamundur pjesëmarrjen në këtë seancë, por që ishte dakort që seanca të zhvillohej në mungesën e tij. Seanca dëgjimore u zhvillua në prezencë të Bashkisë Kamëz, e cila u përfaqësua nga z. L.D, i pajisur me autorizimin nr. 8621 prot., datë 28.10.2020. Procesverbali i seancës dëgjimore, i'u komunikua paditësit në datën 29.10.2020¹¹, i cili depozitoi kundërshtimet e tij në të njëjtën datë.¹²

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i Bashkisë Kamëz ngriti pretendimin për mungesën e kompetencës së Komisionerit, për të shqyrtuar pretendimet e ankuesit. Sipas përfaqësuesit të Bashkisë Kamëz, ankuesi në lidhje me pretendimet e parashtruara në ankesë duhet t'i ishte drejtuar Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ose gjykatës.

Komisioneri e vlerëson të pabazuar në ligj këtë pretendim të Bashkisë Kamëz. Ankuesi pretendon se është diskriminuar gjatë procesit të rekrutimit për vendin e lirë të punës, të shpallur nga Bashkia Kamëz dhe bazuar në nenin 12/1/a/b dhe 32/1/a të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, Komisioneri ka kompetencë të shqyrtojë ankesën e paraqitur në të cilën ankuesi, i cili pretendon se është diskriminuar gjatë procedurave të shpalljes dhe rekrutimit për vendin e lirë të punës të publikuar nga Bashkia Kamëz. Gjithashtu, ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, nuk vendos asnjë detyrim për personat që pretendojnë se janë diskriminuar për t'u drejtuar gjykatës, por ata kanë të drejtën që të zgjedhin midis rrugës administrative përpara Komisionerit ose rrugës gjyqësore, për shqyrtimin e pretendimeve të tyre për diskriminim.

- Me shkresat nr.767/4 prot., datë 30.10.2020 dhe nr. 1673 prot., datë 02.12.2020, Komisioneri kërkoi informacion nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, si institucion i specializuar në fushën e mbikëqyrjes së shërbimit civil, si dhe për faktin se nga verifikimet rezultoi se ky institucion kishte realizuar monitorimin e Bashkisë Kamëz në lidhje me respektimin e legjislacionit të shërbimit civil, gjatë kohës që ankuesi kishte qenë në marrëdhënie pune pranë kësaj bashkie.
- Me shkresën nr. 810/2 prot., datë 09.12.2020¹³, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC), vuri në dispozicion mendimin dhe doskumentacionin e kërkuar. Në këtë

⁹ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 767/2 prot., datë 11.09.2020.

¹⁰ Neni 33/8, ligji nr. 10221/2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*: *“Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”*

¹¹ Komunikimi për paditësin është realizuar në rrugë elektronike, sipas email-it datë 29.10.2020.

¹² Dërgimi i kundërshtimeve nga ana e paditësit është realizuar në rrugë elektronike, sipas email-it datë 29.10.2020.

¹³ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 1726 prot., datë 11.12.2020.

përgjigje, KMSHC, ka parashtruar sa vijon: “.....Në kuadër të verifikimit të këtij rasti, u shqyrtua dokumentacioni i mbikëqyrjes së ushtruar në Bashkinë Kamëz, kryer në bazë të vendimit nr.113, datë 13.10.2015 “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Kamëz”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, prej nga ka rezultuar e vërtetuar që:

Shtetasi E.D, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar (dt.26.02.2014), është evidentuar se ka qenë i punësuar në pozicionin e punës “Specialist i Marrëdhënieve me Publikun dhe Mediat”, për një periudhë më pak se një vit, gjë e cila bazuar në pikën 4, të nenit 67, të ligjit në fjalë, shërbente si bazë për deklarin e tij “nëpunës civil në periudhë prove”, në pozicionin “Specialist i Marrëdhënieve me Publikun dhe Mediat”.

Për këtë arsye, me përmbylljen e procesit të mbikëqyrjes, me vendimin nr.13, datë 29.01.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Kamëz”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në pikën 6, të tij, meqënëse është vlerësuar se është e padrejtë të dëmtohen interesat e nëpunësit civil, për shkak të mosveprimit nga ana e organeve shetërore për kryerjen e veprimeve të kërkuara nga ligji, i është lënë detyrë njësisë përgjegjëse të Bashkisë Kamëz, të konfirmojë statusin e punësimit të nëpunësit E.D dhe të vijonte me plotësimin e dosjes së personelit me dokumentacionin përkatës, duke filluar me nxjerrjen e aktit të deklarin të statusit në kategorinë “nëpunës civil në periudhë prove”. Njëkohësisht, është lënë detyrë që njësia përgjegjëse të vazhdonte procesin duke marrë masat për të zbatuar detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, për nëpunësit në periudhë prove, duke përfshirë përfundimin e trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA), përcaktimin e një nëpunësi më të vjetër për ta udhëzuar në kryerjen e detyrës, si dhe vlerësimin vjetor të punës nga eprori direkt. Vetëm në përfundim të këtij procesi, njësia përgjegjëse duhej të shprehej për konfirmimin, ose jo të këtij nëpunësi civil.

Nëse këto detyrime të lëna në pikën 6, të vendimit nr. 13, datë 29.01.2016 “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të Shërbimit Civil në Bashkinë Kamëz”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nuk janë plotësuar nga ana e njësisë përgjegjëse dhe eprori direkt, nuk mund të përbëjnë shkak për penalizimin e nëpunësit civil, prandaj në analizë të fundit, nëpunësi E.D, në kushtet kur vërtetohet që ka kryer trajnimin me sukses në ASPA, pavarësisht mosveprimit të njësisë përgjegjëse dhe aktorëve të tjerë të ngarkuar nga ligji, duhet të konsiderohet nëpunës civil i konfirmuar.

Nisur nga sa më sipër dhe nga fakti që ai ka përfunduar marrëdhënien në shërbimin civil, në dt. 26.03.2019, nëpërmjet dorëheqjes, bazuar në pikën 4, të nenit 64, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, brenda dt.26.03.2021, ka të drejtë të konkurojë si nëpunës civil, për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26 të këtij ligji.”

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A.Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm

Gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, në datë 15.05.2020, Bashkia Kamëz ka shpallur, njoftimin për vendin e lirë të punës “Përgjegjës i Medias dhe Informimit”, pranë kësaj bashkie, pozicion pune i cili bën pjesë në shërbimin civil. Nga aktet e administruara rezulton se për këtë procedurë konkurimi kanë paraqitur aplikimet dy konkurrentë dhe konkretisht ankuesi në datën 03.06.2020 dhe Xh.S. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Bashkia Kamëz me shkresën nr. 5084/1 prot., datë 23.07.2020 nuk jepet informacion se kur është paraqitur aplikimi nga konkurenti Xh.S. Ndërkohë në informacionin shtesë që i'u kërkua nga Komisioneri, Bashkia Kamës në lidhje me këtë moment ka depozituar aplikimin e paraqitur nga konkurenti Xh.S, i cili mban vulën e protokollit nr.4037 datë 04.06.2020, si dhe kopje nga libri i protokollit, nga ku rezulton se aplikimi i këtij është protokolluar me këtë numër dhe datë protokollit.

Në datën 05.06.2020 Bashkia Kamëz ka njoftuar se në përfundim të procedurës për lëvizje paralele, për këtë konkurs nuk ishte paraqitur asnjë kandidat dhe konkursi do të vazhdonte me procedurën e “ngritjes në detyrë dhe pranimit në shërbimin civil”. Në datën 10.06.2020, Bashkia Kamëz në përfundim të procedurës së “ngritjes në detyrë” për konkursin në fjalë, ka vlerësuar se asnjë nga konkurentët e paraqitur nuk plotësonte kriteret dhe për rrjedhojë është vendosur që konkursi të kalojë në fazën tjetër atë të procedurës së “panimit në shërbimin civil”. Ky vendim është publikuar nga Bashkia Kamëz në datën 11.06.2020 në fazën e saj zyrtare të internetit dhe njëkohësisht në po të njëjtën datë i është komunikuar ankuesit nëpërmjet email-it. Nëpërmjet email-it, Bashkia Kamëz ka njoftuar ankuesin se pas fazës së parë të verifikimit të dokumentacionit, rezultoi se arsyeja e skualifikimit të dosjes së ankuesit ishte ligji 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 26, pika 3, germa “b”, *“nëpunësit civil të një kategorie paraardhëse, të punësuar në të njëjtin apo jo në një institucion tjetër të shërbimit civil, nëse i plotëson kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendin/vendet e punës, nëpërmjet ngritjes në detyrë”*.

Duke mos qenë dakort me skualifikimin, brenda të njëjtës ditë, pra në datë 11.06.2020, ankuesi ka bërë ankesë nëpërmjet adresës së email-it, duke pretenduar se skualifikimi i tij ishte i padrejtë pasi ai gëzonte statusin e nëpunësit civil në nivel ekzekutiv. Ankuesi ka paraqitur ankesë në lidhje me skualifikimin e tij edhe nëpërmjet paraqitjes së një ankese zyrtare e cila rezulton të jetë protokolluar pranë Bashkisë Kamëz me nr.4398, datë 15.06.2020. Duke mos marrë asnjë përgjigje në lidhje me ankesën kundër skualifikimit të tij nga procedura e konkurimit “ngritje në detyrë”, ankuesi ka paraqitur ankesë pranë Komisionerit, duke pretenduar se skualifikimi i tij ka ndodhur për shkak të bindjeve të tij politike. Bashkia Kamëz i ka kthyer përgjigje për ankesën, me shkresën nr. 4398/1 prot, datë 19.06.2020, nëpërmjet të cilës i komunikohet e njëjta arsye për skualifikimin e cila i ishte komunikuar nëpërmjet email-it datë 11.06.2020.

Në vijim, ankuesi ka bërë me dije Komisionerin se, në datën 01.07.2020 ai ka marrë dijeni nëpërmjet faqes zyrtare të Bashkisë Kamëz se kjo e fundit më datë 29.06.2020 kishte publikuar njoftimin për vazhdimin e procedurës së konkurimit dhe kualifikimin e ankuesit për të vazhduar procedurën e pranimit në shërbimin civil. Sipas njoftimit data për zhvillimin e konkursit ishte përcaktuar në 01.07.2020. Sipas pretendimeve të ankuesit, ky njoftim për vazhdimin e procedurave është bërë në shkelje të ligjit, në mungesë transparence dhe se kjo urgjencë për zhvillimin e konkursit kishte si qëllim skualifikimin e tij. Në lidhje me këto pretendime, rezulton se ankuesi ka paraqitur ankesë pranë Bashkisë Kamëz, e cila rezulton të jetë protokolluar me nr.5040, datë 03.07.2020. Ankuesit i është kthyer përgjigje për ankesën me shkresën nr. 5040/1 prot, datë 08.07.2020, nëpërmjet të cilës i komunikohet se njoftimi për datën e konkursit është publikuar në faqen zyrtare të institucionit në datën 29.06.2020 dhe se mosparaqitja e tij në datën dhe orën e përcaktuar për zhvillimin e konkurimit përbënte shkak të drejtëpërdrejtë për moskualifikimin e tij.

Bazuar në aktet e administruara, rezulton se Bashkia Kamëz ka vijuar me procedurat e konkurimit dhe në datën 06.07.2020 ka shpallur rezultatet e konkurimit, sipas të cilit rezulton se, Komiteti i përhershëm i pranimit, në përfundim të procedurës së testimit ka shpallur fitues për pozicionin “përgjegjës i medias” shtetasin Xh.S. Në bazë të urdhrin nr.297, datë 07.07.2020, është bërë emërimi në detyrë i shtetasit Xh.S, si “Përgjegjës i Medias” pranë Drejtorisë së Informacionit dhe marrëdhënieve me Publikun”, në Bashkinë Kamëz.

- Në lidhje me pretendimet e ankuesit për skualifikim të padrejtë nga procedura e “ngritjes në detyrë, Komisioneri vlerëson si më poshtë:

Rezultoi e provuar gjatë shqyrtimit se, ankuesi ka punuar si “specilist i medias” pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun dhe Medias. Ai ka filluar punë në këtë pozicion bazuar në urdhrin nr. 05.11.2013 dhe ka punuar në të njëjtin pozicion pune deri në datën 26.03.2019, kur është larguar nga ky pozicion me dëshirën e tij, pra me dorëheqje.

Bazuar në nenin 67, pika4, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, parashikohet se: “ 4. Nëpunësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, janë nëpunës civilë në periudhë prove dhe për ta zbatohen dispozitat e nenit 24 të këtij ligji. Periudha e provës fillon nga fillimi i shtrirjes së efekteve të këtij ligji.” Është Këshilli i Ministrave, institucioni i cili në zbatim të pikës 8, të nenit 67, të këtij ligji ka miratuar procedurat e hollësishme për zbatimin e këtij neni.

Në bazë dhe për zbatim të nenit të mësipërm, është miratuar nga Këshilli i Ministrave vendimi nr. 116, datë 05.03.2014 “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”. Në pikën 1 dhe 2, të kreu-t III, të këtij vendimi, përcaktohet se: “1. “Punonjës ekzistues”, sipas pikës 3 të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013, që kryejnë funksione të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore e komuna, dhe: a) janë rekrutuar sipas procedurave të ngjashme me ato të përcaktuara nga ligji nr.

8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, por që nuk e gëzojnë statusin e nëpunësit civil; apo b) janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se një vit, janë nëpunës civilë për shkak të ligjit. 2. “Punonjës ekzistues” që mbajnë një pozicion të konsideruar si pjesë të shërbimit civil, sipas ligjit nr. 152/2013, në institucionet e administratës shtetërore e në komunë dhe që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë më pak se një vit, janë nëpunës civilë në periudhë prove. Periudha e provës fillon nga data e fillimit të efekteve të ligjit”

Ankuesi është emëruar në pozicionin e punës “specilist i medias” dhe në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar (dt.26.02.2014), sikundër është evidentuar edhe nga KMSHC gjatë mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil nga ana e Bashkisë Kamëz, rezulton se ankuesi ka qenë i punësuar në pozicionin e punës “Specialist i Marrëdhënieve me Publikun dhe Mediat”, për një periudhë më pak se një vit. Ky fakt bazuar në pikën 4, të nenit 67, të ligjit në fjalë, shërbente si bazë për deklarinimin e tij “nëpunës civil në periudhë prove”, në pozicionin “Specialist i Marrëdhënieve me Publikun dhe Mediat”.

Nuk rezulton që njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Kamëz të ketë nxjerrë aktin për deklarinimin e ankuesit si “nëpunës civil në periudhë prove” në pozicionin që ai mbante, edhe pse KMSHC ka lënë rekomandimet përkatëse. Por, ankuesi ka kryer dhe ka përfunduar me sukses trajnimin e detyrueshëm për nëpunësit civil të administratës vendore në periudhë prove, pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), fakt ky që rezulton i provuar nga çertifikata e lëshuar nga ASPA në datën 16.05.2016. Gjithashtu rezulton se për ankuesin është kryer vlerësimi i punës si nëpunës civil për periudhën 05.01.2016 -31.12.2016, nga ku rezulton se ankuesi është vlerësuar me vlerësimin 1 “shumë mirë”. Nga aktet e administruara nuk rezultojnë vlerësime të tjera pune gjatë kohës që ankuesi ka punuar në pozicionin “specialist i medias”, sikundër rezultoi e provuar se ndaj tij nuk është marrë asnjë masë disiplinore gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës.

Komisioneri në mënyrë të vazhdueshme kërkoi nga Bashkia Kamës, në cilësinë e institucionit ku ankuesi kishte punuar për një periudhë pothuajse 6 (gjashtë) vjeçare, që të vinte në dispozicion aktin e konfirmimit si nëpunës civil për ankuesin ose në të kundërt aktin e moskonfirmimit. Bashkia Kamëz nuk vendosi në dispozicion asnjë akt.

Bazuar në parashikimet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë statusin e nëpunësit civil, si dhe faktet dhe provat e administruara, Komisioneri arrin në përfundimin se ankuesi E.D, pavarësisht mosveprimit të subjekteve të ngarkuar nga ligji, duhet të konsiderohet nëpunës civil i konfirmuar. Mosveprimi i subjekteve të ngarkuara nga ligji, nuk mund dhe nuk duhet të çenojë të drejtat dhe interesat e individëve, në rastin konkret të ankuesit.

Bazuar në pikat 1 dhe 2, të nenit 64, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, parashikohet: “1. Nëpunësi mund të njoftojë përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes me shkrim te njësia e burimeve njerëzore të institucionit, ku ushtron detyrën, ose DAP-it, në rastin e nëpunësit të TND-së. 2. Dorëheqja nuk motivohet dhe i prodhon efektet 30 ditë nga data e paraqitjes së saj.”

Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioneri i gjen të pabazuara pretendimet e përfaqësuesit të Bashkisë Kamëz gjatë seancës dëgjimore datë 28.10.2020, se statusi ruhet kur argumentohet. Sikundër thuhet shprehimisht dhe qartësisht nga dispozita e mësipërme, nëpunësi civil nuk ka asnjë detyrim për të motivuar dorëheqjen.

Arsyeja e skualifikimit të dosjes së ankuesit e njoftuar nga ana e Bashkisë Kamëz, është se ai nuk përmbushte kërkesat se ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 26, pika 3, germa “b”, “nëpunësit civil të një kategorie paraardhëse, të punësuar në të njëjtin apo jo në një institucion tjetër të shërbimit civil, nëse i plotëson kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendin/vendet e punës, nëpërmjet ngritjes në detyrë”.

Procedura për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese, sikundër është pozicioni i punës “përgjegjës i medias” i shpallur për konkurim, parashikohet në nenin 26, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Në pikat 1, 2, dhe 3, të këtij neni, përcaktohet se: “ 1. Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët ose të mesme drejtuese bëhet, së pari, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe, në rast të mosplotësimit të vendit të lirë, me procedurën e ngritjes në detyrë. 2. Këto procedura organizohen nga njësia përgjegjëse, për një ose disa pozicione të lira të ngjashme, bazuar në parimin e përmendur në nenin 20 të këtij ligji. 3. Mund të aplikojnë për procedurat, sipas pikës 1 të këtij neni: a) nëpunësit civilë të së njëjtës kategorie, në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për vendin/vendet e lira nëpërmjet lëvizjes paralele; b) nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse, të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, nëse plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendin/vendet e lira, nëpërmjet ngritjes në detyrë.”

Në pikën 4, të nenit 64, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, përcaktohet se: “4. Nëpunësit civilë, të cilët janë larguar nga shërbimi civil si pasojë e dorëheqjes, kanë të drejtë që të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26 të këtij ligji, deri në 2 vjet pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil.”

Qëndrimet e Bashkisë Kamëz në lidhje me statusin si nëpunës civil të ankuesit janë jo vetëm të pabazuara në ligj por edhe kontradiktore. Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i Bashkisë Kamëz, nga njëra anë shprehet se ankuesi nuk e ka ruajtur statusin si nëpunës civil për shkak se dorëheqja e tij kishte qenë e paargumentuar, ndërkohë që ligji kërkonte detyrimisht që ajo të ishte e motivuar, ndërsa nga na tjetër ai deklaroi se ankuesi nuk mund ta gëzojë statusin njësoj me atë që është në marrëdhënie pune. Komisioneri i vlerëson të pabazuar në ligj të dy këto pretendime, pasi ligji “Për nëpunësin civil” dhe aktet nënligjore që rregullojnë shërbimin civil, nuk kanë asnjë parashikim ligjor që të mbështesë këto pretendime.

Ankuesi ka përfunduar marrëdhënien në shërbimin civil nëpërmjet dorëheqjes, në datën 26.03.2019. Bazuar në pikën 4, të nenit 64, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar,

brenda dt.26.03.2021, ankuesi ka patur të drejtë të konkurojë si nëpunës civil, për procedurat e ngritjes në detyrë, sipas nenit 26 të këtij ligji. Për rrjedhojë skualifikimi i ankuesit nga procedura e ngritjes në detyrë rezulton të jetë bërë në mënyrë të padrejtë. Skualifikimi i ankuesit nga procedura e ngritjes në detyrë ka lejuar dhe ka mundësuar vazhdimin e procedurave për fazën e radhës, atë të pranimit në shërbimin civil, fazë kjo që lejon pranimin e personave nga jashtë shërbimit civil.

- Në lidhje me pretendimet e ankuesit për mungesën e transparencës dhe procedurën e ndjekur për njoftimin e vazhdimin të procedurës së pranimit në shërbimin civil dhe caktimin e datës së konkurimit, Komisioneri vlerëson si më poshtë:

Nga aktet e vedosura në dispozicion nga Bashkia Kamëz, rezulton se, nga data 15.06.2020 e përcaktuar si afati për dorëzimin e dokumentave për procedurën e pranimit në shërbimin civil, njësia përgjegjëse ka kryer verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim, në datën 29.06.2020. Pra, verifikimi është kryer brenda 16 ditëve, që është afati maksimal i përcaktuar për mbylljen e fazës së verifikimeve paraprake, të përcaktuar nga pika 2, kreu IV, të VKM-së nr. 243, datë 18.03.2015 *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, të ndryshuar.

Bazuar në pikën 8, kreu II, të VKM nr. 243, datë 18.03.2015, të ndryshuar, parashikohet se : *“Shpallja e procedurës së pranimit botohet të paktën 35 (tridhjetë e pesë) ditë kalendarike para datës së parashikuar për zhvillimin e konkurimit.”* Kjo dispozitë vendos një afat minimal, por jo një afat maksimal, brenda të cilit duhet të zhvillohet procedura e konkurimit. Në llogjikën e afatit minimal të vendosur nga kjo dispozite, kuptohet që qëllimi ka qenë që aplikantëve të intereuar t’ju lihet kohë dhe të kenë mundësi efektive për të marrë pjesë në konkurim.

Referuar pikës 9, kreu IV, të VKM nr. 243, datë 18.03.2015, i ndryshuar, parashikohet se : *“KPP-ja¹⁴, 24 (njëzetë e katër) orë përpara zhvillimit të fazës së vlerësimit të kandidatëve, zgjedh një grup pyetjesh për testimin e fushës së njohurive, të aftësive e të cilësive të shpallura sipas pikës 9 të kreut II të këtij vendimi”*.

Bashkia Kamëz, e cila është subjekti që ka realizuar procedurën e konkurimit dhe normalisht ka në administrim aktet përkatëse të procedurës së zhvilluar, nuk vuri në dispozicion aktet në lidhje me këtë moment të zhvillimit të konkurimit. Por, nga aktet e administruara rezulton se, shpallja e procedurës është bërë në datën 15.05.2020, ndërsa data kur është zhvilluar konkursi është data 01.07.2020, pra rezulton që data në të cilën është zhvilluar konkursi ka respektuar afatin minimal të parashikuar nga pika 8, kreu II, të VKM nr.243, datë 18.03.2015, të ndryshuar.

Sipas verifikimit të realizuar nga Komisioneri në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Kamëz, rezulton se në datën 01.07.2020, janë njoftuar për t’u zhvilluar edhe tre konkurse të tjera për pranim në shërbimin civil dhe konkretisht për pozicionet: “Koordinator për të Drejtën e

¹⁴ Komiteti i Përhershëm i Pranimit.

Informimit të Publikut” në orën 12.00, “Përgjegjës i Sektorit Juridik” në orën 11.00, “Përgjegjës i Sektorit të Mbrojtjes së Konsumatorit”, në orën 10, ndërkohë që konkursi për pozicionin “Përgjegjës i medias” që i përket ankuesit, ishte caktuar në të njëjtën ditë, por në orën 10.30.

Komisioneri nuk arriti të sigurojë informacion se kur janë shpallur njoftimet për vazhdimin e procedurave të mësipërme, por rezulton se ato duhet të jenë shpallur në kohë të përafërt me procedurën ku ka aplikuar ankuesi, pasi janë në vijimësi të njëra tjetrës. Nga verifikimi i faqes zyrtare të internetit të Bashkisë Kamëz, rezultoi se, jo vetëm procedurat e mësipërme, por të gjitha shpalljet dhe fazat e procedurave të rekrutimit, publikohen duke bërë emërtimin e pozicionit të punës, ndërsa për pozicionin ku ka aplikuar ankuesi është realizuar vetëm publikimi “Vazhdim procedure pranimit”, pa e specifikuar se për cilin pozicion. Mënyra e publikimit të njoftimeve për zhvillimin e rekrutimeve për vendet e lira të shpallura nga kjo bashki, ndjek modelin sipas të cilit, njoftimi i publikuar ka të shënuar edhe pozicionin përkatës. Një gjë e tillë nuk rezulton të jetë ndjekur për njoftimin e realizuar për vazhdimin e procedurës së pranimit për pozicionin që i përket ankuesit, ku ishte njoftuar fakti që ai ishte kualifikuar dhe ishte caktuar data e konkurimit 01.07.2020.

Bashkia Kamëz nuk vuri në dispozicion aktet e mbajtura nga njësi përgjegjëse në lidhje me faktin se, kur ishte njoftuar Komiteti i Përhershëm i Pranimit për listën e kandidatëve të kualifikuar dhe datën e zhvillimit të vlerësimit të kandidatëve, edhe pse i'u kërkua që të vendoste në dispozicion procedurën e ndjekur për fazën e vlerësimit. KPP-ja ka patur detyrimin që të hartonte pyetjet 24 orë përpara zhvillimit të fazës së vlerësimit, pra 24 orë përpara orës 10.00, të datës 01.07.2020 të përcaktuar si data dhe ora për zhvillimin e fazës së vlerësimit të kandidatëve.

Referuar akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi nuk ka ndonjë rregullim në lidhje me këtë moment, por parimi i përgjithshme, jo vetëm i legjislationit për nëpunësin civil, por edhe parimi mbi bazën e të cilit duhet të funksionojë administrata, është ai i transparencës.

Në rastin e njoftimit të publikuar, në lidhje me vazhdimin e procedurës së pranimit, për pozicionin ku kishte aplikuar ankuesi, në të cilin njoftohej për kualifikimin e tij dhe caktimin e datës së punës, rezulton që të ketë një diferencë dhe mungesë transparence, në raport me njoftimet e tjera të publikuara në një periudhë të përafërt, konkursi i të cilave është zhvilluar në të njëjtën ditë me procedurën e konkurimit, objekt i kësaj ankese. Kjo diferencë në lidhje me transparencën e treguar, mund të mos cënonte efektivitetin e njoftimit, nëse do të ishte vendosur në dispozicion një afat më i gjatë për zhvillimin e fazës së vlerësimit. Nga ana tjetër, në rast se Bashkia Kamëz do të kishte ndjekur të njëjtin standart për procedurën e kundërshtuar, sikundër ka ndjekur për procedurat e tjera të ngjashme, pretendimet e ankuesit për mungesë transparence apo mungesë të njoftimit efektiv, do të rezultonin të pa mbështetura. Bashkia Kamëz, nuk dha asnjë justifikim në lidhje me këtë shmangie nga mënyra e publikimit të njoftimeve në raport me rastet e tjera të ngjashme.

Për sa më lart, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, gjatë procesit të rekrutimit për vendin e lirë të punës si nëpunës civil, në pozicionin “Përgjegjës i medias”, të shpallur nga Bashkia Kamëz.

B. Shkaku i mbrojtur

Neni 1, i ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i cili përcakton objektin e këtij ligji, shprehet se ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh. Ky nen parashikon një sërë shkaqesh, por ndërkohë përcakton se lista e shkaqeve të mbrojtura mbetet e hapur.

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1 si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ligji ka bërë në nenin 3, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkaku të mbrojtur jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit.

Ankuesi ka pretenduar se i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm për shkak të “*bindjeve politike*” pasi ai është aktivist dhe anëtar i Partisë Demokratike, bindje këto të kundërta me titullarin e ri të institucionit të Bashkisë Kamëz, i cili është zgjedhur si kryer bashkia si përfaqësues i Partisë Socialiste.

Referuar nenit 1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, shkaku i bindjeve politike, i pretenduar nga ankuesi, konsiderohet si shkak i mbrojtur dhe diferencat në trajtim bazuar në këtë shkak janë të ndaluara dhe të mbrojtura nga ligji.

Në mbështetje të pretendimit të tij ankuesi ka paraqitur kartën e anëtarësimit në Partinë Demokratike, lëshuar në datë 18.06.2014.

Rezulton gjithashtu se, R.S është zgjedhur Kryetar i Bashkisë Kamëz në Qershor 2019, i propozuar si kandidat për Kryetar Bashkie, nga forca politike, Partia Socialiste¹⁵. Gjithashtu R.S, ka qenë deputet në Kuvendin e Shqipërisë, i dalë nga zgjedhjet për Kuvendin, të vitit 2017, si përfaqësues i Partisë Socialiste.

Kodi i Procedurës Administrative, në nenin 80, pika 3, e tij ka përcaktuar se: “*Faktet tashmë të njohura për autoritetin publik ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme*”.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson të provuar shkaku e pretenduar të diskriminimit, atë të “*bindjeve politike*” të kundërta me Kryetarin e Bashkisë Kamëz, titullar i subjektit punëdhënës që ka shpallur vendin e lirë të punës.

¹⁵ Referuar Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve www.cec.gov.al

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë më pak të favorshëm me shkakun e mbrojtur

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit “*Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional*”. Në rastin në fjalë kemi të bëjmë me një marrëdhënie pune midis shtetit dhe individit, e cila rregullohet nga ligji i posaçëm nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Parimi i mosdiskriminimit, përbën një nga parimet mbi bazën e të cilit udhëhiqet administrimi i shërbimit civil, përfshirë këtu rekrutimin e individëve në pozicione pune që bëjnë pjesë në shërbimin civil, parashikuar nga neni 5, i ligjit nr. 152/2013 “Për shërbimin civil”, i ndryshuar.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), nuk parashikon të drejtën për punë si një të drejtë të veçantë, por çështjet e punës trajtohen nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ-ja) si çështje që hyjnë në sferën e veprimit të nenit 8, “*E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare*”. Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë shoqëruese shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë bindjet politike si shkak të mbrojtur. Ndërkohë Protokollit 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, shtrihet përtej të drejtave të mbrojtura shprehimisht nga KEDNJ. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar: (a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë; (b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm; (c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare; (d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik.

E drejta për punë dhe mbrojtja nga diskriminimi në gëzimin e kësaj të drejtë parashikohet edhe në akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria të tilla si:

*Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore*¹⁶, sanksionon të drejtën për punë në nenin 6. Sipas këtij akti ndërkombëtar në fushën e të drejtave të njeriut, i cili është ratifikuar nga vendi ynë, parashikohet se, e drejta për punë përfshin të drejtën e secilit për të pasur mundësinë e sigurimit të jetesës, duke punuar punën e pranuar lirisht dhe marrjen e masave të përshtatshme për ta mbrojtur këtë të drejtë. Sipas nenit 2/2, të Paktit, të drejtat e parashikuara në këtë Pakt duhet të garantohen pa asnjë diskriminim bazuar, ndër të tjera në bindjet politike të personit.

*Konventa Nr.111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës*¹⁷ “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”, përcakton parimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit në fushën e punësimit dhe të profesionit për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi. Konventa e

¹⁶ Ratifikuar me ligjin nr. 7511 datë 08.08.1991

¹⁷ Ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

përkufizon diskriminimin si çdo dallim, përjashtim ose favorizim i bërë në baza të caktuara i cili ka efektin e zhdukjes në barazi dhe mundësi ose trajnim në punësim dhe profesion. Konventa garanton mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të opinionit politik.

*Karta Sociale Europiane*¹⁸ në nenin 1, pika 2, parashikon: “ *Me synimin që të sigurohet ushtrimi efektiv i së drejtës për punë, Palët angazhohen.....2 të mbrojnë efektivisht të drejtën e punëtorit për të fituar jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht...* ” Ky parashikim, është interpretuar vazhdimisht nga Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale (KEDS) si vendosje e një të drejte për të mos u diskriminuar në punësim¹⁹. Garancitë për mbrojtjen nga diskriminimi parashikohen në nenin E), Pjesa V, të Kartës Social Europiane, ku përcaktohet shprehimisht mbrojtja nga diskriminimi për shkak të bindjeve politike.

Ligji “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*” parashikon shprehimisht parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimin. E në fakt mosdiskriminimi dhe parimi i barazisë janë të ndërthurura ngushtë. Parimi i barazisë kërkon që situata të barabarta trajtohen në mënyrë të barabartë dhe situata të jo të barabarta të mënyrë të ndryshme. Dështimi për ta bërë këtë konsiderohet diskriminim, përveç nëse ekzistojnë arsye objektive dhe të arsyeshme.²⁰

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, diskriminimi përkufizohet si: çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi. Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Në bazë të ligjit “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të ligjit “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, përcaktohet se: “*Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi*”. Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

¹⁸ Ratifikuar me ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002.

¹⁹ Shih: *Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë*, prg 30.

²⁰ Raporti Shpjegues që shoqëron Protokollin 12 të KEDNJ-së, prg 15.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t'i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës.

Parimi i zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS²¹ gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm. Bazuar në nenin 82/2 të Kodit të Procedurave Administrative, i cili shërben si bazë ligjore për shqyrtimin e ankesave nga ana e Komisionerit, barra e provës në çështjet e diskriminimit, është objekt i një rregullimi të posaçëm.

Bazuar në nenin 82, pika 2 të Kodit të Procedurave Administrative përcaktohet se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar është shkaku i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës. GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime *“të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave.....provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht me veçoritë e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe me të drejtat e pretenduara”*²².

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim.

Sa më sipër, ankuesi duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjektet kundër të cilëve është drejtuar ankesa, të cilët duhet të tregojnë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

²¹ Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

²² GJEDNJ *Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë* [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147. GJEDNJ, *Timishev v. Rusisë* (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GJEDNJ, *D.H.dhe të tjerët v. Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.

- Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
- Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjektet, që pretendohet se kanë konsumuar sjelljen diskriminuese nuk janë në gjendje të provojë njëherë nga të dyja, atëherë do të jenë përgjegjëse për diskriminimin.²³

Komisioneri çmon të nevojshme të theksoj se, është pikërisht bazuar në standartin e mësipërm të të provuarit, që do të shqyrtojë dhe do të konkludojë në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Bazuar në analizën e mësipërme rezultoi se ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, gjatë shpalljes dhe procesit të rekrutimit për vendin e lirë të punës si nëpunës civil, në pozicionin “Përgjegjës i medias”, të shpallur nga Bashkia Kamëz. Njëkohësisht, sa më sipër, rezultoi e provuar se ankuesi është anëtar i Partisë Demokratike, duke provuar në këtë mënyrë bindjet e tij politike. Ankuesi ka parashtruar se, fakti që bindjet e tij politike janë të kundërta me ato titullarit të subjektit punëdhënës që ka shpallur vendin e lirë të punës, ka sjellë si pasojë trajtimin e tij të padrejtë dhe të pafavorshëm duke e skualifikuar dhe për rrjedhojë duke i mohuar aksesin në procedurat e konkurimit për vendin e punës. Bashkia Kamëz prapësoi gjatë procedurave të shqyrtimit të ankesës se ankuesi nuk është kualifikuar për fazën e ngritjes në detyrë pasi nuk plotësonte kriteret ligjore, ndërsa mosparaqitja e tij në datën dhe orën e caktuar për zhvillimin e konkurimit, është arsyeja që ka sjellë moskualifikimin e tij në fazën e vlerësimit të procedurës e pranimit në shërbimin civil.

Për trajtimin diskriminues në pjesën dërrmuese të çështjeve nuk ekzistojnë prova të drejtpërdrejta. Bindjet politike përbëjnë një të dhënë sensitive të personit dhe shpesh herë punëdhënësi mbrohet me faktin se ai e ka të ndaluar që të mbledhë të dhëna për bindjet politike të punëmarrësve, e për rrjedhojë ai nuk ka si të ketë dijeni për bindjet politike të punëmarrësve të vet. Në lidhje me këtë moment, Komisioneri vlerëson se, provat rrethanore mund të hedhin poshtë pretendimin e punëdhënësit se nuk ka patur dijeni për bindjet politike të punonjësit dhe për këtë arsye të provohet se punëdhënësi ka patur dijeni. Disa fakte dhe prova që mbështesin dijeninë për bindjet politike të ankuesit janë si më poshtë:

Përveç faktit se ankuesi është anëtar i Partisë Demokratike që prej vitit 2014, fakt ky i provuar nga Karta e Anëtarësimit, rezulton se ankuesi ka qenë aktiv në shpaqjen dhe manifestimin e përkatësisë së bindjeve të tij politike me këtë subjekt politik. Ankuesi deklaroi se ai ka qenë aktivist dhe pjesëmarrës në shumë aktivitete publike dhe protesta të zhvilluara nga Partia Demokratike, pretendime këto që mbështeten nga pamjet fotografike/filmike. Aktivizimi dhe pjesëmarrja e ankuesit në organizimet e zhvilluara nga forca politike e mbështetur prej tij, rezultojnë të jenë bërë publike edhe nëpërmjet rrjetin social *Facebook*. Përcjellja e informacioneve

²³ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

dhe publiciteti që përcillet nëpërmjet rrjeteve sociale, përfshirë këtu *Facebook*, nuk mund të vihet në dyshim, dhe për këtë arsye Komisioneri vlerëson që ankuesi të ketë manifestuar publikisht bindjet e tij dhe përkrahjen për forcën politike që mbështet, ku është njëkohësisht i anëtarësuar.

Ankuesi pretendon gjithashtu se trajtimi i padrejtë dhe i pafavorshëm të cilit i është nënshtruar nga Bashkia Kamëz, ka për bazë bindjet e tij politike, pasi marrëdhëniet e tij të mëparshme të punës në Bashkinë Kamëz kanë qenë në kohën kur Bashkia Kamëz drejtohej nga subjekt i zgjedhur nga radhët e Partisë Demokratike, ndërsa tani kjo bashki drejtohet nga subjekt të zgjedhur nga Partia Socialiste. Bazuar në faktet dhe provat e administruara rezulton se ankuesi ka qenë i punësuar pranë Bashkisë Kamëz nga viti 2013-2019, periudhë kjo kohore kur Bashkia Kamëz është drejtuar nga Xh.M, përfaqësues i Partisë Demokratike. Siç është përmenduar edhe më sipër në këtë vendim kjo bashki në zgjedhjet vendore të vitit 2019, është fituar dhe drejtohet nga R.S, përfaqësues i Partisë Socialiste.

Gjatë seancës dëgjimore të datës 28.10.2020, përfaqësuesi i Bashkisë Kamës, duke prapësuar faktin se ankuesi nuk e ruante statusin pasi dorëheqja që ai kishte dhënë në 26.03.2019 kishte qenë e paargumentuar, ndërsa ligji kërkonte që dorëheqja të ishte e argumentuar (pretendim ky që si më sipër është argumentuar se është i pabazuar në ligj), ka deklaruar gjithashtu se: “...ish punëdhënësi duke i konsideruar si punonjës të tyre nuk i ka hyrë pjesës së argumentimit...”. Ky moment tregon se ekziston një qasje e tillë e pretenduar nga ankuesi, sipas të cilës punonjësit që kanë punuar në një periudhë të caktuar kohe konsiderohen si persona që kanë bindje të njëjta politike me ato të titullarit të institucionit.

Komisioneri vlerëson se provat e mësipërme, janë të mjaftueshme në mbështetje të faktit se punëdhënësi ka patur dijeni për bindjet politike të ankuesit.

Bazuar në konstatimet e mësipërme, Komisioneri krijon bindjen se skualifikimi i ankuesit nga procedurat e konkurimit, nuk motivohet nga shkaqe ligjore. Duke iu referuar faktit se, ankuesi është anëtar i subjektit politik Partia Demokratike dhe ka bërë publike bindjet e tij politike, dhe faktit që Bashkia Kamëz nuk arriti të provojë se skualifikimi i ankuesit nga procedura e konkurimit ka ndodhur për një shkak të ligjshëm, krijohet dyshimi se veprimet e Bashkisë Kamëz kanë qenë të motivuara politikisht.

Në rastin konkret argumentat dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesi janë në përputhje me provat dhe informacionin e administruar dhe krijojnë prezumimin se trajtimi i ankuesit në këtë mënyrë, pra skualifikimi i tij nga procedurat e konkurimit, është kryer për motive politike. Në këto kushte Bashkia Kamëz kishte barrën e provës që të provonte ose që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të bindjeve politike dhe trajtimit të pafavorshëm ose duke provuar se megjithëse trajtimi i pafavorshëm është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, në mënyrë që hidhte poshtë pretendimet e ankuesit se këto veprime janë kryer për motive politike. Në mungesë të një justifikimi të tillë lidhur me veprimet e Bashkisë Kamëz, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për skualifikimin mbetet shkakun i diskriminimit të pretenduar nga ankuesi, pra bindjet politike. Në këtë mënyrë plotësohet edhe elementi tjetër i nevojshëm për të përcaktuar nëse diskriminimi ka ndodhur, pra lidhja shkakësore.

Të gjitha veprimet e mësipërme që kanë sjellë skualifikimin e ankuesit nga procesi i konkurimit si në rastin e procedurës së ngritjes në detyrë ashtu edhe procedurën e pranimit në shërbimin civil, janë realizuar nga njësia e burimeve njerëzore, e Bashkisë Kamëz, e cila është njësia përgjegjëse, e kësaj njësie të qeverisjes vendore, sipas parashikimeve të nenit 4, pika 1, germa “f”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku përcaktohet: “Njësi përgjegjëse” është Departamenti i Administratës Publike (DAP) për institucionet e administratës shtetërore dhe njësia e burimeve njerëzore për institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore.”

Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë (KPND) në rastin e procedurës së ngritjes në detyrë dhe Komiteti i Përhershëm i Pranimit (KPP) në rastin e procedurës së pranimit në shërbimin civil, të cilët janë organe kolegiale që krijohen gjatë procedurave të rekrutimit sipas ligjit dhe akteve nënligjore për nëpunësin civil, kanë detyra dhe përgjegjësi vetëm gjatë fazës së vlerësimit të kandidatëve. Ankuesi nuk ka arritur të kalojë në këtë fazë të konkurimit, për shkak të trajtimit të padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i është nënshtruar, si pasojë e veprimeve të njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë Kamëz, e cila është strukturë dhe pjesë përbërëse e bashkisë. Për rrjedhojë edhe përgjegjësia për veprimet e kësaj njësie, bie ndaj institucionit të Bashkisë Kamëz.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, Bashkia Kamëz ka diskriminuar ankuesin E.D në të drejtën për punësim. Për rrjedhojë Bashkia Kamëz ka shkelur dispozitat e ligjit nr.10221, datë 04.02.2020 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nenin 3, pikat 1 dhe 2, nenin 5, pika1 dhe nenin 12, pika 1, gërmat “a” dhe “b”.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 33 pikat 10, 11 e 12, të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të ankuesit E.D, në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Bashkisë Kamëz.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Shkaku: Bindjet politike
Fusha: Punësim
Lloji i vendimit: Diskriminim
Forma : I drejtëpërdrejtë